

**Hapet thirrja për aplikime për studentët e doktoraturës  
në Universitetin e Romës "Foro Italico"- Itali,  
në kuadër të programit Erasmus+ për vitin akademik 2024-2025**

Në kuadër të programit Erasmus+ është hapur thirrja për aplikime për 3 (tre) bursa për mobilitete për studentët e ciklit të tretë të studimeve pranë Universitetit të Romës "Foro Italico", Itali për vitin akademik 2024-2025.

<http://www.uniroma4.it/>

**Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e studentëve PhD për studime;

**Nivelet e mobilitetit për studentët:**

- Doktoraturë;

*Studentët aplikues duhet të plotësojnë këto kushte:*

1. Të jenë studentë të regjistruar në programet e ciklit të tretë të studimeve të ofruara nga UST;
2. Të jenë punonjës me kontratë të plotë punësimi në UST;
3. Të kenë njohje të gjuhës italiane dhe/ose të gjuhës angleze të certifikuar sipas udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Studentët me njohje të mirë të gjuhës italiane kanë përparësi;
4. Studentët aplikues duhet të paraqesin platformën e studimit që do të zhvillojnë në Universitetin e Romës "Foro Italico", e cila duhet të jetë pjesë integrale e punimit të dizertacionit të miratuar.

**Kohëzgjatja e bursave:**

- Nga 2 (dy) javë deri në 1 (një) muaj

**Fushat e shkëmbimit:**

Bursat/mobilitetet,do të jenë në fushat si vijon:

- Shkencat sportive dhe shëndeti

**Bursat përfshijnë:**

- Kompensimin prej 70 euro/dita;
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës);

Për të përcaktuar distancën ju lutem referojuni link-ut:

<https://erasmus-plus.ec.europa.eu/resources-and-tools/distance-calculator>

- ✚ Studentë që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus+ nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës.
- ✚ Studentët do të vazhdojnë të paguajë shkollimin e tyre dhe/ose tarifat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

### **Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e ciklit të tretë:**

- *CV në gjuhën angleze (formati EUROPASS);*
- *Fotokopje e pasaportës;*
- *Vërtetim studenti;*
- *Listë notash të niveleve të mëparshme të studimit;*
- *Letër motivivimi në gjuhën angleze, ku specifikohet arsyeja e dëshirës për të marrë pjesë në këtë mobilitet dhe se si konkretisht ky mobilitet do të ndihmojë kerkimin e kandidatit;*
- *Çertifikatë e gjuhës së huaj (anglisht/italisht);*
- *Letër rekomandimi nga drejtuesi i tezës (shqip/anglisht);*

### **Afati për aplikim: 16 tetor 2024**

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi deri më **16 tetor 2024**, pranë Zyrës së Protokollit në UST dhe të dërgohen të skanuara në adresën e-mailin [erasmus@ust.edu.al](mailto:erasmus@ust.edu.al).

Për më shumë informacion mbi bursat e mobiliteteve mund të na kontaktoni në adresën; [erasmus@ust.edu.al](mailto:erasmus@ust.edu.al)

*Universiteti i Sporteve të Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!*